

KORIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 832, datë 24.12.2021, “Për deklarinimin pasuri kulturore ‘Qendër historike’ të fshatit Bënjë, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen e administrimin e tyre”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 204, datë 30.12.2021, faqe 20612, bëhet korigjimi i gabimit material në titull dhe numërtim, si më poshtë:

VENDIM

Nr. 832, datë 24.12.2021

PËR DEKLARIMIN PASURI KULTURORE “QENDËR HISTORIKE” TË FSHATIT BËNJË, PËRCAKTIMIN E ZONËS MBROJTËSE TË SAJ DHE MIRATIMIN E PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN E ADMINISTRIMIN E TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 3, shkronjat “a” e “ç”, dhe 96, pika 1, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin pasuri kulturore “Qendër historike” të fshatit Bënjë, sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Përcaktimin e zonës mbrojtëse të “Qendrës historike” të fshatit Bënjë, sipas koordinatave dhe hartës së zonimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Vendimi nr. 776, datë 2.11.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e qendrës historike të fshatit Bënjë dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, shfuqizohet.
5. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartën e “Qendrës historike” të fshatit Bënjë dhe të zonës mbrojtëse të saj në Gjeoportalin Kombëtar.
6. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Përmet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama